



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1683/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI135/20

Parashtrues

Hava Behxheti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
ARJ-UZVP. nr. 122/2019, të 18 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hava Behxheti, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila para Gjykatës Kushtetuese përfaqësohet nga avokatja Albana Kelmendi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr. 122/2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të 18 nëntorit 2019, të cilin e ka pranuar më 19 maj 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), ne ndërlidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 shtator 2020, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 27 shtator 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dorëzua Gjykatës Supreme.
8. Më 27 tetor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë informata përkitazi me datën e pranimit të Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 122/2019] të Gjykatës Supreme nga parashtruesja e kërkesës.
9. Më 28 tetor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë informoi Gjykatën se Aktgjykimi [ARJ-UZVP. nr. 122/2019] i Gjykatës Supreme, i 18 nëntorit 2019, i është dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 19 maj 2020.
10. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri/me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesja e kërkesës, në janar të vitit 2005, kishte lidhur kontratë pune në kohë të caktuar me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS), në kohëzgjatje prej 1 janarit 2005, deri më 31 dhjetor 2006, për pozitën “nëpunëse administrative” në Qendrën Rajonale të Punësimit të DPP-së.
12. Më 1 dhjetor 2006, MPMS mori vendim për shuarjen e disa vendeve të punës në MPMS, me qëllim të reformimit dhe ristrukturimit të administratës në kuadër të MPMS-së, duke përfshirë edhe pozitën e parashtrueses së kërkesës “nëpunëse administrative”, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore dhe numrit të stërngarkuar të personelit administrativ, duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës ku parashihej zvogëlimi i të punësuarve në shërbimin civil.
13. Më 6 dhjetor 2006, MPMS, përmes një njoftimi e informoi parashtruesen e kërkesës se vendi i saj i punës është shuar sipas dispozitave në fuqi dhe se kontrata e punës e parashtrueses së kërkesës, e cila skadon më datën 31.12.2006, nuk mund të vazhdohet.
14. Më 29 dhjetor 2006, MPMS, përmes vendimit, shkëputi marrëdhënien e punës së parashtrueses së kërkesës në vendin e punës të nëpunësit administrativ në Qendrën Rajonale të Punësimit në Prishtinë/Departamenti për Punë dhe Punësim.
15. E pakënaqur me këtë Vendim, parashtruesja e kërkesës paraqiti një kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHC) për anulimin e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës në MPMS.
16. Më 30 mars 2007, KPMSHC, përmes Vendimit A/02/93/2007, kishte refuzuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në MPMS për shkak se kontrata e punës me kohë të caktuar kishte skaduar si dhe për shkak të reformave dhe ristrukturimit të brendshëm të administratës në MPMS.
17. Më 3 shkurt 2015, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, kundër Vendimit [A/02/93/2007] të KPMSHC-së, të 30 marsit 2007, me të cilin nuk është aprovuar kërkesa e saj për anulimin e Vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në MPMS. Parashtruesja e kërkesës përmes padisë kërkoi gjithashtu pagesën e pagave të papaguara për periudhën prej 1 janari 2007 deri në daljen e saj në pension.
18. Më 2 maj 2017, parashtruesja e kërkesës kishte bërë precizimin e padisë, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit [A/02/93/2007] të KPMSHC-së, të 30 marsit 2007, duke argumentuar se me vendimin e shkallës së parë shkëputja e marrëdhënies së punës ishte bërë në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ 2000/3, si dhe për faktin se vendimi është kundërtshënës dhe

- kontradiktor me arsyetimin. Ne lidhje me ushtrimin e padisë Gjykata Themelore kishte njoftuar të paditurën KPMSHC.
19. Më 23 janar 2018, e paditura KPMSHC dorëzoi përgjigje në padi me propozimin që padia e parashtrueses së kërkesës të refuzohet si e pabazuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të vërtetohet Vendimi nr. A/02/93/2007, i KPMSHC-së, i 30 marsit 2007, si i bazuar në ligj.
 20. Më 24 janar 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit A. nr. 192/2015, refuzoi, si të pabazuar, padinë e parashtrueses së kërkesës me të cilën kërkoi anulimin e Vendimit A/02/93/2007 të së paditurës KPMSHC-së, të datës 30.03.2007, me arsyetimin se *"...gjykata ka vërtetuar se paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në pajtim me dispozitat ligjore, respektivisht në kuptim të nenit 35.1 (b) [të] Urdhëresës Administrative 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36, pasi që paditësja ka lidhur kontratë në kohë të caktuar, të njëjtës i ka skaduar afati, çka do të thotë se të drejtat dhe detyrimet e palëve janë shuar ndërsa, organi i punësimit nuk ka pasur mundësi ta vazhdoj kontratën për shkak të shuarjes së vendeve të punës dhe i njëjti nuk mund të zëvendësohej me ndonjë vend të ngjashëm në kuadër të MPMS, andaj rrjedhimisht punësimi i paditëses ka përfunduar automatikisht"*.
 21. Më 26 shkurt 2018, parashtruesja e kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të vërtetimit jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkeljeve të pretenduara të ligjit material dhe procedural, me propozimin që Aktgjykimi i gjykatës së shkalles së parë të priset.
 22. Më 5 shkurt 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit A. A. nr. 147/2018, refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtrueses së kërkesës, ushtuar kundër Aktgjykimit [A. nr. 192/15] të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe vërtetoi këtë të fundit si të drejtë, me arsyetimin vijues: *"...në këtë çështje juridike administrative, në procedurë administrative dhe në procedurë gjyqësore të shkallës së parë drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar ligji material, ndërsa pretendimet në ankese të paditëses nuk provohen me prova të argumentuara për tu vendosur në favor të sajë dhe janë të pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative juridike"*.
 23. Më 2 prill 2019, parashtruesja e kërkesës parashtrroi në Gjykatën Supreme kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kundër Aktgjykimit [A. A. nr. 147/2018] të Gjykatës së Apelit, të 5 shkurtit 2019, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material dhe shkeljes së dispozitave të ligjit procedural, duke kërkuar aprovimin e kërkesës së saj, ndryshimin e aktgjykimit të goditur dhe njohjen e të drejtës legjitime.
 24. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ARJ-UZVP. nr. 122/2019, refuzoi si të pabazuar kërkesën për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të ushtuar nga parashtruesja e kërkesës kundër Aktgjykimit [A. A. nr. 147/2018] të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit [A. nr. 192/15] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vërtetuar të dy aktgjykimet në fjalë si të drejta dhe të bazuara në ligj.

25. Në pjesën relevante të arsyetimit të Aktgjykimit [ARJ-UZVP. nr. 122/2019], të Gjykatës Supreme, thuhet:

“Nga shkresat e lëndës është vërtetuar se organi i paditur, duke i zbatuar procedurat administrative, drejtë ka vepruar kur ka refuzuar, si të pabazuar ankesën e paditëses. Kjo gjykatë ka konstatuar se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (shkurt. MPMS), me datën 01.12.2006, me qellim të reformimit dhe ristrukturimit të administratës, ka marrë vendim për shuarjen e disa vendeve të punës në MPMS, duke përfshirë edhe vendin e punës të paditëses “punëtore administrative”. Ky vendim për shuarjen e disa vendeve të punës është marrë për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore dhe numrit të stërngarkuar të personelit administrativ, duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 06/2014 në të cilin përfshihej zvogëlimi i numrit të punësuarve në Shërbimin Civil dhe masat për ngritjen e punësimit të shërbyesve civil në IPVQ dhe Rregulloren nr. 2006/61 për miratimin e AKK për periudhën 01.01 - 31.12.2007, ku parashihej numri i lejuar i të punësuarve në shërbimin civil që rezultonte me numrin e zvogëluar të punëtoreve. Nga shkresat lëndës vërehet se paditësja është njoftuar nga MPMS nga data 01.12.2006 për shuarjen e disa vendeve të punës në MPMS, me qellim të reformimit dhe strukturimit të administratës dhe ndër to ka qenë edhe vendi i punës “punëtor administrativ”, në Qendrën Rajonale të Punësimit të DPP-së, në të cilën ka qenë e punësuar paditësja. Lidhur me këtë vendim paditësja është njoftuar nga MPMS me njoftimin e datës 06.12.2006, që kontrata e punës me kohë të caktuar, prej 01.12.2005 deri me 31.12.2006 nuk do të vazhdohet, ndërsa me aktvendimin nr.1724 dt.29.12.2006 e datës 29.12.2006 i është ndërpre marrëdhënia e punës. Bazuar në nenin 35.1 (b) të Urdhërësës Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36, pasi që paditësja ka lidhur kontrate të punës me kohe të caktuar të njëjtës i ka skaduar afati me datë 31.12.2006, çka do të thotë se të drejtat dhe detyrimet e palëve janë shuar, ndërsa organi i punësimit nuk ka pasur mundësi ta vazhdojë kontratën për shkak të shuarjes së vendeve të punës dhe i njëjti nuk mund të zëvendësohej me ndonjë vend të ngjashëm në kuadër të MPMS-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata Supreme i refuzon si të pabazuara pretendimet e paditëses, ndërsa atë të prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktgjykimit të goditur përbënë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejt i së drejtës materiale dhe nuk është cenuar ligji në dem të paditësit.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenin 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të

Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.

27. Parashtruesja e kërkesës nuk arsyeton se në çfarë mënyre janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], por shkeljet e këtyre neneve i ndërlidh me shkeljen e nenit 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së.
28. Sa i përket shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Themelore në Prishtinë prej momentit të ushtrimit të padisë (2007), mori vendim në vitin 2018, duke e zvarritur çështjen e saj në kundërshtim me parimin e nxjerrjes së vendimit brenda kohës së arsyeshme.
29. Parashtruesja e kërkesës tutje pretendon se Gjykata e Apelit shkeli gjithashtu të drejtën e saj për gjykim të drejtë, sepse nuk e trajtoi pretendimin e saj në lidhje me tejzgjatjen e procedurës dhe vendosjen e çështjes brenda kohës së arsyeshme nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë parashtruesja e kërkesës ia adreson edhe Gjykatës Supreme, duke theksuar se: *“Gjykata Supreme e Kosovës merr aktgjykim me të cilin refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditëses për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, mirëpo pa e arsyetuar pretendimin se pse gjykata nuk ka trajtuar çështjen meritore në afatet ligjore të defnuara sipas ligjit”*.
30. Bazuar në sa më sipër, parashtruesja e kërkesës pretendon se: *“Në bazë të kësaj që është listuar me lartë aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme qartë dëshmojnë veprimet e kundërligjshme dhe si të tilla shkelin të drejtat e garantuara. Të drejtat e shkelura mbuloohen edhe nga instrumentet ndërkombëtare zbatimi i të cilave është i obligueshëm për Kosovën, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe gjithashtu edhe Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GjEDNj”)”*.
31. Për me tepër, parashtruesja e kërkesës thekson se zgjidhja e çështjes së tejzgjatjes se procedurave nga Gjykata Kushtetuese do të mundësonte që në të ardhmen personave të tjerë që ballafaqohen me mohimin e kësaj të drejte për gjykim të drejtë t’ua zbuste dhimbjet, duke shtuar se deklarimi i Gjykatës përkitazi me këtë do të krijonte *“...precedent për gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës se si të veprojnë në rastet kur ballafaqohen me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të cilët janë palë në procedurën administrative”*.
32. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: *“ta konstatojë të pranueshme kërkesën e saj; të konstatojë se dështimi për të ofruar një gjykim të drejtë paraqet shkelje të të drejtave individuale të saj, të garantuara me nenin 31 të Kushtetues dhe nenin 6 të KEDNj-se; dhe të përcaktojë çfarëdo të drejtë ose përgjegjësie për palët në këtë kërkesë që kjo Gjykatë i vlerëson si të arsyeshme dhe të bazuara juridikisht”*.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

35. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

36. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, se ajo

konteston një akt të autoritetit publik dhe i ka shteruar mjetet juridike në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur nga autoritetet publike, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

37. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë së kërkesës në pajtueshmëri me rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënrrregullin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

38. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelen të drejtat e saj, të garantuara me nenet 3, 22, 24, 31.2 të Kushtetues, dhe nenin 6. të KEDNj-së.

39. Nga shkresat e lëndës, Gjykata verën se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës bie në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, meqë ankesa e saj ndërlidhet me tejzgjatjen e procedurës në gjykatat e rregullta, respektivisht me të drejtën për një gjykim të drejtë në kohë të arsyeshme.

40. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31.2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNj).

41. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton përmbajtjen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNj-së, që përcaktojnë:

Neni 31.2 i Kushtetutës

[...]

2. “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

Neni 6.1 i KEDNj-së

1) “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj...”

[...]

42. Fillimisht, Gjykata vë në dukje se neni 6.1 i KEDNj-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të dëgjuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme, dhe nëse është e nevojshme, t'i bashkojnë procedurat, t'i pezullojnë ato apo edhe të hedhin poshtë vendimet për procedura të reja (për më tepër, shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, të 1 prillit 2014, ankimet nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, paragrafi 91).
43. Sa i përket shtrirjes në kohë të procedurave, Gjykata merr parasysh kriteret e përcaktuara në Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Tomazič kundër Sllovenisë*, e 2 qershorit 2008, ankimi nr. 38350/02, paragrafi 54, ku përcaktohet: “Sa i përket arsyeshmërisë së zgjatjes së procedurave, [GJEDNJ] thekson se kjo duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret në vijim: i. kompleksitetin e rastit, ii. sjelljen e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve relevante, si dhe iii. çfarë ishte në pyetje për parashtruesin në këtë mosmarrëveshje”.
44. Sipas kuptimit të nenit 6 paragrafit 1 të KEDNj-së, llogaritja e procesit, shtrirjes në kohë të procedurave, fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastin *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 64, shih gjithashtu rastin *Poiss kundër Austrisë* GJEDNJ, të 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, GJEDNJ, të 15 korrikut 1982, paragrafi 74).
45. Gjykata fillimisht e sheh të nevojshme të theksojë se nuk posedon prova dhe dëshmi se çfarë hapa procedural ka ndërmarrë parashtruesja e kërkesës nga viti 2007 deri me 3 shkurt 2015, andaj kjo periudhë nuk mund të merret parasysh nga Gjykata.
46. Sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës së Gjykata Themelore në Prishtinë, nga momenti i ushtrimit të padisë e kishte zvarritur zgjidhjen e çështjes së saj deri në vitin 2018, Gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe verën se padia në Gjykatën Themelore në Prishtinë ishte ushtruar me 3 shkurt 2015 dhe më pas ishte precizuar më 2 maj 2017. Pas kësaj date, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte ndërmarrë disa veprime procedurale, duke përfshirë edhe njoftimin e të paditurës (KPMSHC) për ushtrimin e padisë, deri në mbajtjen e seancës së shqyrtimit më 24 janar 2018, ku dhe vendosi përkitazi me padinë, duke e refuzuar të njëjtën si të pabazuar. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se përkitazi me padinë e parashtrueses së kërkesës Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi në kohëzgjatje prej afërsisht 3 vjetësh.
47. Tutje, Gjykata verën se parashtruesja e kërkesës, më 26 shkurt 2018, kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila lidhur me ankesën vendosi më 2

shkurt 2019. Shikuar momentin e ushtrimit të ankesës dhe datën e vendosjes për ankesën, Gjykata verën se ky proces gjyqësor zgjati afërisht 1 (një) vit.

48. Gjykata verën gjithashtu se parashtruesja e kërkesës, më pas kishte ushtruar mjetin e jashtëzakonshëm dhe më 2 prill 2018 i është drejtuar Gjykatës Supreme me kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Gjykata respektive në fjalë përkritazi me këtë mjet juridik vendosi më 18 nëntor 2019, që nënkupton se lidhur me kërkesën u vendos në afat prej afërsisht 7 (shtatë) muajve.
49. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se çështja e parashtruesës së kërkesës në të tri instancat gjyqësore ishte zgjidhur në kohëzgjatje prej afërisht 5 (pesë) vjetësh.
50. Gjykata vë në dukje se parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat proceduralë të vënë në dispozicion të tyre nga ligjet në fuqi. Megjithatë, ata duhet të kenë parasysh, gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në shtyrjen në kohë të procedurave (shih rastin *McFarlane kundër Irlandës*, GJEDNj, të 10 shtatorit 2010, aplikimi nr. 31333/06, paragrafi 148, shih, gjithashtu, Gjykata Kushtetuese, rasti KI127/15, parashtrues: *Mile Vasović*, Aktvendim i 5 qershorit 2017, paragrafi 51).
51. Për më tepër, Gjykata rikujton se sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm që kërkojnë dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së (shih, GJEDNj, rasti *Eckle kundër Gjermanisë*, aplikimi nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).
52. Gjykata dëshiron të vë në dukje se veprimet procedurale të ndërmarra nga parashtruesit e kërkesave nuk mund t'i atribuohen si vonesa gjykatave, sepse shtrirja në kohë e procedurave efektivisht llogaritet nga momenti i vënies në lëvizje të gjykatës së juridiksionit përkatës, kur mëson për mjetin juridik të ushtruar nga palët, deri në datën e vendosjes përfundimtare për çështjen.
53. Rrjedhimisht, në dritën e rrethanave të këtij rasti, Gjykata, duke marrë parasysh sjelljen e parashtrueses së kërkesës dhe të autoriteteve relevante, arrin në konkluzion se gjykatat respektive, që nga momenti i vënies në lëvizje të tyre, kanë qenë mjaft aktive duke vendosur brenda limitëve kohore të arsyeshme. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
54. Sa i përket pretendimeve të tjera të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk arsyeton se në çfarë mënyre janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], por shkeljet e këtyre neneve i ndërlidh me shkeljen e nenit 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 [E

drejta për një proces të rregullt] të KEDNj-së. Gjykata nuk e konsideron si të nevojshme trajtimin e tyre veç e veç, përderisa thelbi i ankesës ka të bëjë me pretendimin për shkelje të nenit 31.2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, respektivisht me të drejtën për një vendim përfundimtar në kohë të arsyeshme (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI127/15, parashtrues: *Mile Vasović*, Aktvendim i 5 qershorit 2017, paragrafi 54).

Përfundim

55. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të deklarohet, në tërësinë e saj, si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 dhjetor 2020, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi